



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:220676

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05729753

C.nr.2115/202

1

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.R. me numër personal S.T. me numër personal S.M. me numër personal, S.D.H. me numër personal.... dhe S.B. me numër personal . që të gjithë nga Mamusha, kundër të paditurës Komuna e Mamushës-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mamushë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 13,469.76 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.R., S.T., S.M., S.D.H. dhe S.B., që të gjithë nga Mamusha, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, Komuna e Mamushës, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, t'i paguaj shumat si në vijim:

- Paditëses S.R. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 2,656.80 euro;
- Paditësit S.T. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 2,656.80 euro;
- Paditësit S.M. për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 31 muaj e 18 ditë (për çdo muaj shumën prej 51.66 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 393 euro, si dhe për 18 ditë shumën prej 30.99 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,632.45 euro;
- Paditëses S.D.H. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 2,656.80 euro;
- Paditëses S.B. për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 2,656.80 euro;

Të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 01.10.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 412.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit S.M. përtej shumës së gjykuar si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit, përkatësisht shuma prej 1,210.11 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

A r s y e t i m

Paditësit S.R., S.T., S.M., S.D.H. dhe S.B., që të gjithë nga Mamusha, përmes të autorizuarit të tyre av.A.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Mamushës, Drejtoria Komunale e Arsimit, Mamushë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 13,469.76 euro.

Paditësit në padi kanë theksuar, se janë të punësuar si mësimdhënës pranë SHFMU "Anadolu" në Mamushë, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Tutje, kanë theksuar se duke u bazuar në nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, paditësit kanë fituar të drejtën e tyre në kompensim në bazë të kualifikimit-licencimit. Gjithashtu në nenin 33 pika 1.1 e UA nr.5/2017 Sistemi i Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, vazhdohen për 5 vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014, licencat e lëshuara në këto vite mbeten të vlefshme deri në periudhën e realizimit të VPM. Ndërsa për mësimdhënësit e licencuar pas vitit 2015 vlen pika 1.2 e nenit 33 të UA nr.5/2017. Meqenëse paditësit i kanë shterur të gjitha mundësitë lidhur me realizimin e të drejtave të tyre dhe deri në ditën e parashtrimit të padisë nuk kanë mundur të i realizojnë ato, kanë kërkuar mbrojtje gjyqësore. Bazuar në të lartcekurat i kanë propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar.

Me parashtrësën e datës 19.09.2022, paditësit kanë precizuar dhe saktësuar kërkesëpadinë, duke vepruar sipas aktvendimit të kësaj gjykate, ashtu që kanë kërkuar nga gjykata që kërkesëpadija e paditësve të aprovohet nga data 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021, dhe të detyrohet e paditura, që paditësve S.R., S.T., S.M., S.D.H. dhe S.B., t'ia paguajë shumën prej 2,656.80 euro, secilit nga ta, ndërsa paditësit Seany Mazrek, t'ia paguajë shumën prej 2,842.56 euro, pasi që e paditura një pjesë të mjeteve ia ka paguar paditësve për çdo muaj.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve për kompensimin e shtesave mbi bazën e kualifikimit të theksuara në padi i ka kontestuar për faktin se DKA në Mamushë, bazuar në nenin 7 pika 1.3 dhe nenin 8 pika 1.5.1 dhe 1.5.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit, të gjithë paditësve dhe të gjithë arsimtarëve me kualifikim të punësuar pranë SHFMU "Anadolu" për çdo muaj është duke ia paguar

kompensimin e shtesave mbi bazën e kualifikimit, kjo dëshmuar edhe me listën e pagave ku shihet se paditësit janë duke i marrë nga 58.32 euro në muaj. Nga lista e pagave shihet qartë se paga bazë e paditësve është 421 euro, nëse e kalkulojmë vlerën e kërkuar nga paditësit e cila sipas KKA është 27% e pagës bazë, del se paditësit duhet të përfitojnë 113.67 euro për një vit. Realisht në bazë të listave të pagave vërtetohet se paditësit për një vit në emër të kualifikimit janë duke përfituar shumë më prej 699.84 euro, e cila tejkalon vlerën e cekur në dispozitivin e KKA të thirrur nga ana e paditësve. Sikur shihet nga lista e pagave, paditësit përfitojnë vlerë më të madhe se ajo që e kanë kërkuar përmes padisë e cila përbën një diferencë 586.17 euro. Andaj, pasi që paditësit kanë realizuar të drejtën e për shtesat mbi bazën e kualifikimit, nëse do të bëhej edhe njëherë kompensimi për një gjë të tillë do të vinte në shprehje pasurimi pa bazë bazuar në nenin 194 të LMD-së. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit S.R., S.T., S.M., S.D.H. dhe S.B., janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHFMU “Anadolu” në Mamushë. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. 049/15 e datës 01.04.2015, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja S.R. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e filologjisë, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 406, e datës 18.05.2004 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin profesor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr.050/15 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi S.T. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 203, e datës 05.02.2015 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimi-Qendra në Prizren, në emër të paditësit, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr.002/18 e datës 01.09.2018, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi S.M. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 258, e datës 26.05.2016 e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Edukimi në Prizren, në emër të

paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin bachelor i programit parashkollor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 393.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 54.45 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr.051/15 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja S.D.H. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 124, e datës 18.06.20009 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimi-Qendra në Prishtinë, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i mësimit klasor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr.053/15 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi S.B. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 207, e datës 05.02.2015 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimi-Qendra në Prizren, në emër të paditësit, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësime të drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësime të drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësime të drejtorëve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t'ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve S.R., S.T., S.D.H. dhe S.B., ia ka paguar shumën prej 58.32 euro, ndërsa paditësit S.M. ia ka paguar shumën prej 54.45 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit S.R., S.T., S.D.H. dhe S.B., përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro, ndërsa paditësi S.M. përfiton ngritje prej 27%, që në rastin konkret paditësi përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 106.11 euro.

Mirëpo, duke marrë parasysh që kërkesa e paditësve është parashtruar lidhur me pagën bazë në lartësi prej 421.00 euro, gjykata vendosi që paditësve S.R., S.T., S.D.H. dhe S.B., i takon pjesa e diferencës së papaguar lidhur me pagën bazë në shumë prej 421.00 euro apo në shumë prej 55.35 euro, ndërsa paditësit S.M. në shumën prej 51.66 euro pasi që paga bazë e të njëjtit është në lartësi prej 393.00 euro. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve S.R., S.T., S.D.H. dhe S.B., për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 55.35 euro, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 18.04.2021 apo për 48 muaj, shumën e përgjithshme prej 2,656.80 euro, ($48 \times 55.35 = 2,656.80$ euro), ndërsa paditësit S.M. për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 51.66 euro, për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 deri më datë 18.04.2021 apo për 31 muaj e 18 ditë, shumën e përgjithshme prej 1,632.45 euro ($31 \times 51.66 = 1,601.46$ euro si dhe për 18 ditë, $51.66/30 = 1,722 \times 18 = 30.99$), andaj ($1601.46 + 30.99 = 1,632.45$ euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 01.10.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër sa i përket pjesës refuzuese, gjykata ka refuzuar një pjesë të kërkesëpadisë së paditësit S.M. për faktin se bazuar në kontratën e punës i njëjti ka filluar marrëdhënien e punës pranë të paditurës me datë 01.09.2018 dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë fillojnë të rrjedhin nga momenti i lidhjes së saj pra me datë 01.09.2018, si dhe nga lista e pagave gjykata ka vërtetuar se paga bazë e të njëjtit është në lartësi prej 393 euro e jo siç ka pretenduar paditësi se është në lartësi prej 421 euro, andaj mbi këto baza gjykata ka refuzuar një pjesë të kërkesës së paditësit dhe atë në lartësi prej 1,210.11 euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 30.08.2018. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësës është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit

399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësve t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 412.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 312.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 100.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.2115/2021, datë 24.05.2024

Gjyqtari,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.